



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Nr.174, data: 06.06.2024

Duke u mbështetur në nenin 9 të UA nr. 04/2022 lidhur me Detyrat dhe Përgjegjësit e DKA-së për Organizimin dhe Mbarëvajtjen e Garave me nxënës në nivel të shkollës, komunës dhe nivelin nacional, Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport, për nder të “18 Qershorit-Ditës së Çlirimit të Komunës së Kamenicës”, shpall:

Konkurs

Për fotografinë më të mirë të shkrepur nga qytetarët e Komunës së Kamenicës e që pasqyron bukuritë natyrore, infrastrukturën moderne, trashëgiminë kulturore, jetën tonë në këtë hapsirë

Qëllimi:

- **Pasqyrimi i bukurive natyrore:** Përmes fotografive do të pasqyrohen bukuritë natyrore të komunës sonë.
- Ndjenja e gjithpërfshirjes: Konkursi do të krijoj një ndjenjë të fortë gjithpërfshirjeje të qytetarëve duke punuar në një projekt të përbashkët;
- **Ekspozitë të fotografive :** Pjesëmarrësve në konkurs, do t’u japim mundësinë për të shfaqur perspektivat e tyre në ekspozita të organizuara nga DKRS dhe vlerësuar edhe nga komuniteti.

Kriteret:

1. Çdo qytetarë i Komunes së Kamenicës ka të drejtë të dërgoj fotografi, respektivisht të marrë pjesë në konkurs, me maksimum dy fotografi;
2. Fotografia duhet të paraqes imazh nga Komuna e Kamenices;
3. Secila foto e dorëzuar ne email duhet të shoqërohet me një përshkrim i shkurtër ku është realizuar fotografia.;
4. Fotografia mund të realizohet me aparat fotografik profesional, aparat fotografik jo profesional ose një telefon të mençur;
5. Fotografia mund të kalojë vetëm nëpër editim bazik (nuk lejohen fotomontazhet apo manipulime të tjera);
6. Fotografia duhet të jetë me kualitet të lartë;
7. Të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Kamencës;

Fotografitë duhet të dergohen në emailin dardanafotokonkurs@gmail.com

Do të shpërblehen 3 fotografitë më të mira. - Fotografia e parë më e mirë me 300 euro;
- Fotografia e dytë me 200 euro
- Fotografia e tretë me 100 euro

Afati i dorëzimit të fotografive deri më datën 15.06.2024

Fotografitë më të mira përzgjidhen nga komisioni profesional vlerësues i formuar nga DKRS dhe do të ekspozohen në shtëpinë e kulturës me datë 18.06.2024